



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:229524

Datë: 19.04.2022

Numri i dokumentit: 02930198

PKR.nr. 183/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA NË GJILAN, në trup gjykues të përbërë prej gjyqtarëve : **Aziz Shaqiri** – kryetar i trupit, **Islam Thaçi** dhe **Veli Kryeziu** – anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve : **L. Z.** nga fshati Muçibabë, Komuna e Gjilanit, për shkak të dy veprave penale të grabitjes nga neni 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s) dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-s, të cilin e mbron sipas **detyrës zyrtare av. Arta Syla** – nga Gjilani si të akuzuarit **Sh. R.** nga Gjilani, për shkak të veprës penale dhënia e ndohmës kryesit pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 paragrafi 2 nënparagrafi 2.9 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-s të cilin sipas autorizimit e mbron **av. Abdulla Ismajli** nga Gjilani, ndaj të cilit edhe është veçuar procedura penale në kuptim të nenit 36 të Kodit të procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti i krimeve të rënda në Gjilan PP.I.nr. 177/2021 të datës 05 nëntor të vitit 2021, të cilën e përfaqësoj prokurori i shtetit Mr.sc. Agron Uka, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datën 08 prill të vitit 2022, nxjerr kurse në prani të palëve më datën **12 prill të vitit 2022** kryetari i trupit gjykues publikisht komunikon këtë,

A K T G J Y K I M

I.I akuzuari L. Z. nga i ati E. dhe e ëma V. – me mbiemër të vajzërisë G., i lindur më 14.08 2003 në Gjilan, me vendbanim në fshatin Muçibabë, komuna e Gjilanit, posedues i lejes së njoftimit me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore tetëvjeçar, i papunësuar, me gjendje të varfër ekonomike, i gjykuar më parë për vepër penale lidhur me narkotikë, mirëpo organi i ndjekjes penale gjykatës nuk i ka ofruar aktgjykim të plotfuqishëm lidhur me këtë vepër penale, nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, i është tërhequr vërejtja se është **i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të adresës personalisht ose përmes mbrojtëses së tij edhe atë gjer në vendosje përfundimtare** lidhur me këtë lëndë penale, nën kërcënim të pasojave ligjore, me të dhëna tjera personale si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor,

Ë s h t ë f a j t o r

1. sepse në periudhën kohore dy ditore të njëpasnjëshme në Gjilan, i akuzuari L. Z. me dashje paraprake, duke përdorur forcën dhe kanosjen serioze për të sulmuar jetën dhe trupin e personit tjetër edhe atë me armë - revole mod PP, të kalibrit 9 mm, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme monetare për vete ose tjetrin edhe atë :

më datën 11 tetor të vitit 2021, rreth orës 13:25 minuta, në rrugën “ Isa Boletini “ edhe atë prapa Stacionit të autobusave - filial i pagesave “ **Ria Vllasa Transfer** “, i maskuar me kapelë duksi në kokë, me syza me dioptri të madhe si dhe me një maskë anticovid ka hyrë në lokal të këtij filiali dhe nën kërcënim të armës që t’ia jap parat që i kishte në kasë, duke i thënë të dëmtuares Doruntina Demi e cila si kasiere ishte duke punuar në kasë “ **a po i qet krejt paret çka i ki** “ ashtu që i njëjti fillimisht shkrep një herë me armë në afërsi të saj e pastaj e godet të njëjtën në anën e djathtë të shpinës dhe nga kasa merr shumën e parave në vlerë prej **490 Euro** duke ikur nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur,

kurse më datën 12 tetor të të njëjtit vit – 2021, rreth orës 11:20 minuta në rrugën “ Xheladin Kurbaliu “ prapë i maskuar me një kapelë duksi në kokë dhe me një maskë antikovid ka hyrë në marketin “ Bum 3 “ fillimisht duke i nxjerrë 50 cent për të paguar një çokollatë ashtu që derisa ishte duke ia kthyer kusurin e dëmtuara Shkurte Rustemi, nën kërcënim të armës duke i thënë të njëjtës “ **qiti paret** “, pasi që e dëmtuara bërtetë duke kërkuar ndihmë “ o Arsim “ i akuzuari i merrë nga kasa parat në shumën prej **530 Euro**, ashtu që në atë moment derisa del nga zyra i dëmtuari si menaxher A. H., i akuzuari ia drejton armën dhe shkrep një herë në drejtim të tij, e pastaj i njëjti merr një bisht fshise në market dhe vërsulet në drejtim të të akuzuarit duke vrapuar pas tij afro 200 metra, mirëpo i akuzuari shkrep me armë edhe një herë në drejtim të tij e pastaj ik nga vendi i ngjarjes nëpër shtëpi të banuara dhe nëpër lokale të ndryshme, mirëpo pas një pune operative të zyrtarëve policor i njëjti identifikohet dhe në të njëjtën ditë rreth orës **13,00** arrestohet,

-ashtu që i njëjti **me veprimet e tilla ka kryer** veprën penale të **grabitjes në vazhdim** nga **neni 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 77** të KPRK-s dhe

2. meqë në kohë të papërcaktuar i akuzuari L. pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët ka mbajtur në pronësi armën e zjarrtë edhe atë një revole me gaz të markës RECK Mod PP. të kalibrit 9 mm, me numër serik M157471, made in Germany, e cila pas kryerjes së grabitjeve më datën 11 dhe 12 tetor të vitit 2021, pikërisht ditën e fundit më 12. Tetor 2022 rreth orës 13,00 konfiskohet nga ana e zyrtarëve policor,

-ashtu që me veprimet e tilla i akuzuari ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve** nga **neni 366 paragrafi 1. të KPRK-s.**

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave të cituara dhe dispozitave nga nenet 4, 7, 21, 38, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 paragrafi 1 duke e zbatuar në mënyrë të përshtatshme nënparagrafin 1.2 si dispozitë materiale të përgjithshme më të favorshme për të akuzuarin, e me rastin e caktimit të dënimeve për secilën veprë penale lëndore në kuptim të nenit 76 paragrafi 1. të KPRK-s, të akuzuarit fillimisht për veprën penale në dispozitivin I.1.i cakton dënim kumulativ **me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vjet e gjashtë (6) muaj** dhe **dënim me gjobë në shumën prej nëntëqind (900) Euro** kurse për veprën penale në dispozitivin I.2. i cakton **dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) Euro**, e pastaj në kuptim të nenit 76 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 të KPRK-s, të akuzuarin L. Z.

E G J Y K O N

ME DËNIM UNIK edhe atë :

-me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vjet e gjashtë (6) muaj, të cilin dënim duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm dhe

-me dënim unik me gjobë në shumën prej njëmijëedyqind (1,200) Euro, të cilën shumë duhet ta paguaj në gjashtë këste të barabarta prej nga **200 Euro në muaj,** duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo, në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s, nëse eventualisht i akuzuari L. nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti

I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, të cilin duhet të filloj ose vazhdoj ta mbaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së ftesës së kësaj gjykate për mbajtjen e këtij dënimi.

II. Në kuptim të nenit 79 paragrafi 1 të KPRK-s, në dënimin me burgim të akuzuarit L. i llogaritet koha e kaluar paraburgim duke filluar nga data **12 tetor të vitit 2021 e gjer më datën 12 prill të vitit 2022.**

III. Në kuptim të nenit **366 paragrafi 3 të KPRK-s** të akuzuarit L. i **konfiskohet** arma e zjarrtë – një revole e markës RECK me gaz, Mod PP.me kalibër 9 mm, me numër serik M157471, made in Germany, kurse **në kuptim të neniot 284 të KPP-s, i konfiskohen :** një mulli për grirje të mariohanës, një çokolladë kit kat, mondhat në apoena 1x50 Euro, 4x10 Euro, 2x5 Euro, 1x2 Euro, 1x100 Euro, 6x50 Euro, 2x2 Euro, 2x0,20 cent, 1x0,10 cent, një telefon mobil i markës samsung mod SM-G850F me numër serik R58F91ERZHA, një telefon mobil i markës Samsung mod GT-C3310, një mulli për grirje të mariohanës, një çokolladë kit kat, mondhat në apoena 1x50 Euro, 4x10 Euro, 2x5 Euro, 1x2 Euro, 1x100 Euro, 6x50 Euro, 2x2 Euro, 2x0,20 cent, 1x0,10 cent, një telefon mobil i markës samsung mod SM-G850F me numër serik R58F91ERZHA, një telefon mobil i markës Samsung mod GT-C3310, me numër serik RF1CA2YFFPI, sik kartel IPKO, dy shkrepsa, një pako cigare Winston dhe një brisk, ashtu që edhe **arma edhe sendet tjera** do të shkatërrohen përmes komisionit të formuar nga ana e kryetarit të kësaj gjykate, kurse **shuma e parave** do të derdhet në arkën e buxhetit të Republikës së Kosovës, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, përkatësisht me të njëjtat do të **kompenzohet dëmi monetar** i shkaktuar të dëmtuarëve me rastin e kryerjes së veprës penale të **grabitjes në vazhdim** për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari në fjalë.

IV.DETYROHET i akuzuari **L. Z. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale** lidhur me **ekspertizën psikiatrike** të ekspertëve psikiatër të paguaj shumën prej katërqindpesëdhjetë (450) Eurove, në emër të **paushallit gjyqësor** shumën prej pesëdhjetë (50) Eurove, ndërsa në emër të **takësës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) Eurove,** të gjitha në afat prej tridhjetë (30) ditëve, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

V. DETYROHET i akuzuari **L. Z.** që të dëmtuarës filiala e pagesave **Ria Vllesa Transfer me seli në Gjilan – rruga “ Isa Boletini “ p.n. – pas Stacionit të Autobusve të këtij qyteti, t’ia paguaj shumën prej katërqindëntëdhjetë (490) Eurove,** kurse **marketit “ BUM 3 “ me seli në Gjilan rruga “ Xheladin Kurbalia “ p.n. shumën prej pesëqindetridhjetë (530) Eurove,** e të cilat shuma në mënyrë të kundërligjshme me vepër penale i ka grabitur nga kasat

e të njëjtave më datën 11 përkatësisht 12 tetor të vitit 2021, edhe atë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, duke filluar nga dita pasuese e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

VI. Të dëmtuarat : **D. D.** nga babai Sh. dhe **Sh. Rr.** nga babai R. që të dyja me vendbanim në Gjilan - lagja “ Arbëria “ p.n. për realizimin e **kërkesave pasurore juridike të tyre** lidhur lëndimet trupore dhe frikën e shkaktuar me rastin e grabitjeve së parave gjersa kanë qenë duke punuar si kasierë në kasat e subjekteve ekonomike Ria Vllesha Transfer dhe marketin BUM 3 me seli në Gjilan, **udhëzohen në kontest të rregullt civil.**

VII.I akuzuari **L. Z.** është liruar nga masa e paraburgimit me aktvendim të posaçëm.

VIII. Ndaj të akuzuarit **Sh. R.** nga Gjilani është **veçuar procedura penale me aktvendim procedural, për shkak se i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale nga neni 380 paragrafi 2 nënparagrafi 2.9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, duke u urdhëruar Zyra kompetente e kësaj gjykate që të fotokopjoj shkresat e lëndës duke i dhënë numër tjetër të protokollit për vazhdimin e procedurës penale ndaj këtij të akuzuari edhe atë përmes programit të SMIL-it.**

A r s y e t i m

a. Hyrje në arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti i krimeve të rënda pas zhvillimit të hetimeve më datën 05 nëntor të vitit 2021 kundër dy të akuzuarve në fjalë ka ngritur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari L. Z. në kohën, vendin, mënyrën dhe me mjetin – revole me gaz të përshkruar më gjerë në dispozitivat e aktakuzës ka kryer dy grabitje nga neni 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-s si dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1. të KPRK-s, kurse i akuzuari Sh. R. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar më gjerë në dispozitivin e aktakuzës lëndore ka kryer veprën penale dhënia e ndihmës kryesitë pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 paragrafi 2 nënparagrafi 2.9 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-s.

Prokurori i shtetit gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se : meqenëse i akuzuari L. ka pranuar fajësinë vullnetarisht, pa presinon, pa dhunë dhe i vetëdijshëm për veprimet e tij për tri veprat penale sipas aktakuzës lëndore, ka konsideruar se gjykata duhet të merrë parasysh dispozitën e nenit 69 të KPRK-s edhe atë rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit që nënkupton se me rastin caktimit të dënimit, gjykata duhet të marrë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për këto vepra.

Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën dhe natyrën e veprës, sjelljet dhe rrethanat por edhe mënyrën e kryerjes nga ana e kryerësit. Gjykata duhet të merr parasysh dispozitën e nenit 70 të KP lidhur me rregullat e përgjithshme të matjes së dënimit lidhur me rrethanat lehtësuese ashtu edhe ato rënduese. Si **rrethanë rënduese** duhet të merrë parasysh **shkallën e lartë të rrezikshmërisë shoqërore , shkallën e lartë të elementit të dashjes** për të kryer veprën penale, se vepra penale është kryer **nën kërcënim të armës**, se në rastin konkret kemi **tri viktima ose thjeshtë tre të dëmtuar, mënyrën e kryerjes së veprave penale** ndërsa si **rrethana lehtësuese** të merrë parasysh moshën e re të të akuzuarit, gjendjen e dobët ekonomike, por edhe rrethanaën se i pandehuri që në fazën e stadiit të parë të procedurës penale

duke përffshirë edhe fazën e hetimeve i pandehuri është penduar për veprimet e tij të inkriminuara. Duke i marrë parasysh këto rrethana gjykatës i propozojmë që të akuzuarin ta shpall fajtor duke ia shqiptuar një dënim të arsyehëm dhe në proporcion me peshën dhe natyrën e veprave penale, në mënyrë që tek i njëjti të ndikoj pozitivisht rreth resocializimit, riedukimit dhe integritetit të akuzuarit në shoqëri, në mënyrë që i njëjti dhe të tjerët mos të kryejnë vepra tjera penale.

Pas dhënies së fjalës përfundimtare nga ana e mbrojtjes së të pandehurit, prokurori i shtetit ka shtuar se sa i përket ekzaminimit mjeko-ligjor dhe konstatimit si dhe përfundimit të atij raporti në mënyrë të qartë dhe shprehimore është konstatuar se kjo kategori e personave mund të kenë kontroll në veprimet e ndërmarra. Sa i përket asaj se a kemi të bëjmë me vepër penale në vazhdim ka konsideruar se duhet të analizohet ky rast nga trupi gjykues duke marrë parasysh se nuk kemi të bëjmë ne persona të njëjtët të dëmtuar, intervalet kohore ndryshojnë, andaj edhe ka konsideruar se kemi të bëjmë me vepra penale të ndara e jo të vazhdueshme, e mbi këtë bazë edhe gjykatat duhet të marrë një vendim të drejtë i cili është në pajtim me dispozitat ligjore. Sa i përket ekspertizës në faqen 3 dhe 7 nuk është e kontestueshme se në kohën e kryerjes së veprës veprimet apo llogaritshmëria e të pandehurit ka qenë e zvogëluar, por në rastin konkret nga përshkrimi dhe përmbajtja e këtij raporti të ekspertëve rezulton konstatimi se mund të kenë kontroll në veprimet e të akuzuarit në fjalë, pavarësisht nga ajo se llogaritshmëria e të pandehurit është e zvogëluar.

I dëmtuari A. H. si menaxher i pikës “ Bum 3 “ ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe se ka kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit të parë (L.) pasi që në këtë pikë janë grabitur shuma e parave prej 530 Euro, e për ta mbështet këtë ekzistojnë prova edhe atë të nxjerra nga kamerat e sigurisë, mirëpo disçka me shkrim për ta arsyetuar këtë shumë nuk ka, përkatësisht provën e tillë e ka sjell në gjykatë lidhur me lartësinë e dëmit monetar të shkaktuar BUM 3 me seli në Gjilan, e cila është në shumën prej 530 Euro.

E dëmtuara **Sh. R. Rr.** ka deklaruar se në pikën e BUM 3 me seli në Gjilan, ka punuar në kohën kur ka ndodhur grabitja si kasiere dhe se në momentin kur është krye grabitja nuk e ka ditë saktësisht se sa para i janë grabitur nga kasa na i akuzuari në fjalë, mirëpo më vonë me rastin e dorëzimit tëndërrimit është konstatuar shuma e saktë përkatësisht brenda 15 minutave nga momenti i kryerjes së grabitjes shuma prej 530 Euro, mirëpo me shkrim me vete asgjë nuk ka për ta mbështetur këtë thënie, edhe pse kjo është e vërtetë.

E dëmtuara më tutje ka shtuar se me rastin e grabitjes nga ana e grabitës me armë në dorë është shqetësuar shumë bile dhe se në atë kohë ka qenë edhe shtatëzënë, mirëpo sa i përket asaj që ka të bëjë me kërkesën pasurore juridike kjo e dëmtuar ka deklaruar se i mbetet gjykatës për ta vendos.

Pas dhënies së deklarasë përfundimtare nga kjo e dëmtuar, kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar të dëmtuarën Sh. rr. se këtë çështje nuk mund t'ia lë gjykatës për ta vendos sipas detyrës zyrtare, sepse është çështje e saj se a e kërkon shpërblimin e dëmit jo material apo, e dëmtuara në fjalë në këtë rast ka mbetur pranë të njëjtit konstatim.

E dëmtuara D. Sh. D. ka deklaruar se në kohën kur ka ndodhur rasti i grabitjes ka qenë duke punuar si kasiere- arkatare në institucionin financiar jo bankar “ Vllesa Ria “ me seli në Gjilan, e cila gjendet pas Stacionit të autobusve në Gjilan. Me rastin e barazimit të arkës është konstatuar se mungojnë 490 Euro, të cilat edhe janë grabitur nga ana e të akuzuarit, e për mbështetjen e këtyre thënieve është dorëzuar lista me të dhëna konkrete sa i përket kësaj

shume, gjersa ka punuar si kasiere – arkatare në këtë institucion. Ka shtuar se me rastin e grabitjes së parave i pandehuri i ka shkakuar edhe lëndime trupore dhe se prova e tillë gjendet në dokumentacion të gjykatës. Ka deklaruar se nuk është e autorizuar konkretisht për ta parashtruar kërkesën pasurore mirëpo gjykata duhet të veproj sipas provës që e ka në shkresa të lëndës.

Po ashtu kjo e dëmtuar ka shtuar se gjykatës i parshtron kërkesë pasurore juridike për shkak të lëndimeve trupore dhe shqetësimeve që ka pasur gjatë grabitjes derisa ka punuar si kasiere në Institucionin në fjalë.

Mbrojtësja e të akuzuarit L. Z. edhe atë av. Arta Sylja nga Gjilani gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se : gjykata me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit duhet t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë : pranimin e fajësisë si rrethanë veçanësisht lehtësues pasiqë ka pranuar fajësinë që nga faza e hetimeve por edhe në prokurori, pendimin e thellë për veprimin e pamatur të tij, gjendjen e tij të varfër ekonomike, ambientin dhe kushtet në të cilat jeton – në një ambient rural larg atij urban duke mbetur vetëm me shkollë fillore tetëvjeçare për shkak të mentalitetit përkatës, nivelin e ultë të arsimimit meqë ka të kryer vetëm shkollën fillore tetëvjeçare e cila e qonë të pandehurin në nivel të ultë të shkallës së përgjegjësisë penale të tij, moshën e tij të re pasi që ende nuk i ka mbushur 19 vjet, gjendjen e tij shëndetësore e cila gjendje e tij është evidentuar edhe në raportin e ekzaminimit psikiatrik të lëshuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë i datës 22.02 2022 ku edhe është konstatuar se si pasojë e intervenimit kirurgjik në kokë në vitin 2015 tek i njëjti janë paraqitur sulmet progresive epileptike.

Në raportin e ekzaminimit psikiatrik është konstatuar se ditët kritike llogaritshmëria e të pandehurit L. për veprat penale për të cilat akuzohet ka qenë **e zvogëluar**, një gjendje e tillë karakterizohet me çrregullimet e sjelljes, mosrespektimit të normave shoqërore, abuzim me substancat psikoaktive, e në rastin konkret edhe me ataqe epileptiforme të cilat janë pasojë e sëmundjes bazë të tumorit të ekstirpuar (shfarosëse – extirpation). Bazuar në nenin 77 të KPRK-s ka konsideruar se në rastin konkret sa i përket dispozitivit I. dhe II. të aktakuzës , kemi të bëjmë me vepër penale në vazhdim pasiqë kemi të bëjmë me dy vepra penale të natyrës së njëjtë të cilat janë kryer në lidhmëri kohore nga i njëjti kryes dhe për të cilat plotësohen së paku dy prej kushteve të parapara me këtë nen. Në rastin konkret kemi objektin e njëjtë (të natyrës së njëjtë) si dhe formën e njëjtë të dashjes nga ana e kryesit.

Andaj, edhe nga gjykata ka kërkuar që këto dy vepra penale t'i konsideroj si një vepër penale dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim nën minimumin e paraparë ligjor, e po ashtu meqenëse në raportin e cekur më lartë tek i akuzuari leugtrim është evidentuar çrregullim mendor i quajtur çrregullim organik i personalitetit të koduar me shifrën F07.8 sipas ICD 10 dhe EPI SECONTARIA. Në bazë të këtij raporti psikiatrik mbrojtja i propozon gjykatës që ndaj të pandehurit të shqiptoj ndonjërin prej masave të parapara në kapitullin V. të KPRK-s konkretisht masën e paraparë në nenin 86 të KPRK-s

Meqenëse kanë pushuar arsyet ligjore për të cilat është caktuar maa e paraburgimit ka kërkuar nga gjykata që të njëjtit t'i ndërpritet masa e paraburgimit.

Sa i përket vërejtjeve të prokurorit të shtetit ka dhënë shpjegimin si në vijim : në ekspertizë faqe 3 dhe 7 thuhet se : bazuar në të gjeturat tona gjatë eksplorimit psikiatrik dhe bazuar në dinamikën e veprës ditën klritike llogaritshmëria e tij për veprën për të cilën akuzohet ka qenë e zvogëluar , ndërsa sa i përket asaj se dy veprat e grabitjes nuk mund të konsiderohen si vepra penale të vazhdueshme, sipas mbrojtjes në rastin konkret për,mbushen së paku dy kushte të

parapara me ligj, e të cilat u elaboruan më lartë, andaj edhe ka mbet pranë propozimit që këto dy vepra penale të grabitjes të trajtohen si vepër penale e vazhdueshme. Ka shtuar edhe atë se dy ditëve kritike sipas ekspertëve psikiatër për shkak të gjendjes shëndetësore të të akuzuarit L. aftësia e tij mendore ka qenë e zvogëluar.

Vlen të theksohet se pasiqë i pandehuri është njoftuar me të drejtat e tij, pas konsultimit me mbrojtësen e tij i njëjti me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë ka deklaruar se e pranon fajësinë për të tri veprat penale të cilat i vihen në ngarkesë të njëjtit edhe atë sipas përshkrimit faktik të veprave të tilla. Këtë nuk e ka kundërshtuar as mbrojtësja e të akuzuarit e as prokurori i shtetit si përfaqësues i aktakuzës lëndore.

Trupi gjykues lidhur këtë ka nxjerr aktvendim procedural me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit L. Z. lidhur me dy veprat penale të grabitjes si dhe për veprën penale nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-s, me arsyetim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 326 paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 248 paragrafi 1. të KPP-s. Palët këtë aktvendim nuk e kanë kundërshtuar.

Në këtë fazë të procedurës prokurori i shtetit ka kërkuar ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor me qëllim që të ketë kohë të mjaftueshme për ta shqyrtuar këtë situatë, meqë i pandehuri L. ka pranuar fajësinë për tri veprat penale ndërsa i pandehuri Sh. R. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në ngarkesë me aktakuzën lëndore. Pas pushimit 15 minutësh të aprovuar nga trupi gjykues, prokurori i shtetit i ka propozuar trupit gjykues që për të akuzuarin përkatës të veçohet procedura penale, duke u vazhduar seanca e shqyrtimit gjyqësor lidhur me të akuzuarin L. Z. edhe atë me fjalët përfundimtare të palëve.

Mbrojtësit e të akuzuarve dhe të akuzuarit nuk e kanë kundërshtuar këtë propozim. Trupi gjykues pas shqyrtimit të propozimit lëndore ka nxjerr aktvendim procedural me të cilin ka veçuar procedurën penale ndaj të akuzuarit Sh. R.t, pasiqë i njëjti nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ndaj të cilit edhe do të vazhdohet seanca gjyqësore ndaras, ndërsa ndaj të akuzuarit L. Z. paraprkishtë vazhdohet seanca me fjalët përfundimtare të palëve përfshirë edhe të dëmtuarit si palë pasiqë të njëjtit janë deklaruar se kanë kërkesa pasurore juridike.

Po ashtu vlen të theksohet se pas përfundimit të seancës gjyqësore ndaj të akuzuarit L. Z. për të cilën me aktvendim procedural është caktuar data e seancës për shpalljen e aktgjyqimit, zyra kompetente e administratës së kësaj gjykate është urdhruar që sipas aktvendimit të vaçantë të veçimit të procedurës penale të përcjell edhe me programin SMIL, të merr numër tjetër të protokollit lënda e veçuar ndaj të akuzuarit Sh. R., edhe atë duke u vazhduar procedura penale ndaj tij, e cila edhe është shtyr për datën 05 maj të vitit 2022.

b) Përfundimet e nxjerra nga gjykata me rastin e pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit L. Z. për tri veprat penale për të cilat është akuzuar

Gjykata pasi që e ka njoftuar të akuzuarin L. Z. me të drejtat nga neni 323 të KPP-s edhe atë pas leximit të dispozitivave të aktit akuzues, i akuzuari L. pas konsultimit me mbrojtësen e tij ka pranuar fajësinë për të tri akuzat.

Trupi gjykues pasiqë paraprkishtë asnjëra palë nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë për të tri veprat penale nga ana e të akuzuarit L. Z., vlerësoj se në kuptim të nenit 326 paragrafi 4 lidhur

me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-s janë përmbushur të gjitha kërkesat për pranimin e fajësisë nga ana e këtij të akuzuari, edhe atë si në vijim :

-se i akuzuari L. ka aftësi për të kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për tri veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës lëndore, pasi që sipas raportit të ekspertëve psikiatër të datës 22.02 2022, ndër të tjera është konstatuar se i akuzuari mund të merrë pjesë në seancë gjyqësore, ta përcjell seancën e shqyrtimit gjyqësor, të kuptoj pyetjet e parashtruara dhe të jap përgjigje në ato pyetje, edhe pse bazuar në të gjeturat gjatë eksplorimit psikiatrik të të akuzuarit në fjalë aftësia mendore e këtij të akuzuari gjatë dinamikës së kryerjes së këtre tri veprave penale lëndore ka qenë e zvogëluar (vërejtja gjyqësore : pra i njëjti nuk ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar në kuptim të nenit 18 lidhur me nenin 85 dhe 86 të KPRK-s, për të cilat dispozita ligjore janë dhënë sqarimet e nevojshme në arsyetim të këtij aktgjykimi),

-se pranimin e fajësisë lidhur me tri veprat penale lëndore i akuzuari L. e ka bërë me vullnet të lirë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare,

-se pranimi i fajësisë për tri veprat lëndore penale mbështetet në faktet relevante të tri ngjarjeve penale që i përmban aktakuza lëndore, e të cilat rezultojnë nga provat materiale dhe personale përfshirë edhe mbrojtjen e të akuzuarit L. si dhe mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të psikiatrisë të nxjerr në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe observimit të të akuzuarit në Institutin e Psikiatrisë Fornezike në Prishtinë, e të cilat gjenden në shkresa të lëndës, edhe pse të njëjtat nuk janë administruar si prova por janë çmuar nga trupi gjykues gjatë vendosjes,

-se aktakuza lëndore lidhur me tri akuzat përkitazi me të akuzuarin L. nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike qoftë edhe rreth mospërshkrimit të ndonjë veprave penale sipas ligjit, edhe pse trupi gjykues do të jep arsyetimin përkatës lidhur me trajtimin e dy veprave penale të grabitjes si një vepër penale të grabitjes në vazhdim nga neni 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1. dhe nenin 77 të KPRK-s.

c) Dispozitat ligjore lidhur me tri veprat penale për të cilat i akuzuari L. ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe dispozitat përkatëse të procedurës penale

I) Dispozitat materiale

Sipas **nenit 317 paragrafi 1. të KPRK-s** parashihet : Kushdo që me përdorimin e forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasuroe të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjetë.

Paragrafi 3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. të këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë deri në dymbëdhjetë vjet.

Sipas **nenit 366 paragrafi 1 itë KPRK-s** parashihet : Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtaëmijë e pesëqind Euro ose me burgim deri në pesë vjet.

Sipas **nenit 77 paragrafi 1. të KPRK-s parashihet : Vepra penale në vazhdim** përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim :

- 1.1.viktimës së njëjtë të veprës penale,
- 1.2objektit të njëjtë të veprës penale,
- 1.3.shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore,
- 1.4.vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale ose
- 1.5.dashja e njëjtë e kryesit.

Paragrafi 2. Veprat penale të kryera kundër personit mund të konsiderohen si vepra penale në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person.

Neni 71 paragrafi 1. I KPRK-s parasheh : Gjykata mund të shqiptoj dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptoj lloj më të butë të dënimit :

1.1...

Nënparagrafi 1.2. kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethna posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë ose

Nënparagrafi 1.3 në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Neni 72 paragrafi 1. të KPRK-s parasheh : Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim :

Nënparagrafi 1.1. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ultë dënimi me burgim prej së paku dhjetë vjet, dënimi mund të zbutet deri në pesë vjet burgim,

Nënparagrafi 1.2. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ultë dënimi me burgim prej së paku pesë vjet, dënimi mund të zbutet deri në tri vjet burgim,

Paragrafi 2. I të njëjtit nen parasheh : Me rastin e vendosjes së shkallës së zbutjes së dënimit sipas paragrafit 1. të këtij neni, gjykata në veçanti merr parasysh shkallën më të ulët dhe më të lartë të dënimit të paraparë për vepër penale.

Sipas nenit 18 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-s parashihet se në cilat raste tek kryesi i veprës penale ekziston paaftësia mendore por edhe aftësia e zvogëluar mendore.

Vlen të theksohet se nëse eventualisht vërtetohet me prova se tek kryesi i veprës penale në kohën e dimanikës së kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohet ka ekzistuar **vetëm aftësia e zvogëluar mendore, në këto raste gjykata këtë mund ta merr parasysh vetëm si rrethanë lehtësuese në kontekst me rrethanat tjera me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ose dënimeve. Mirëpo, vetëm nëse plotësohen kushtet ligjore nga neni 85 ose 86 lidhur me nenin 84 të KPRK-s gjykata kryesit i cili nuk ka qenë penalisht përgjegjës (që ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore) apo që është vërtetuar se ka aftësi esencialisht të zvogëluar mund t'ia shqiptoj ndonjëri prej masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik qoftë me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor qoftë edhe në liri.**

Për arsyet e lartcekura, gjykata ka refuzuar propozimin e mbrijtëses së të akuzuarit L. për caktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, meqë nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 86 të KPRK-s, edhe pse për mbajtjen e stabilitetit shëndetësor të të akuzuarit

L. mund të vendos vetëm spialisti kompetent i psikiatrisë se është apo jo e nevojshme tretmani përkatës mjeklsir për këtë të akuzuar.

II) Dispozitat e procedurës penale

Sipas nenit 36 paragrafi 1 të KPP-s parashihet : Gjykata e cila sipas këtij Kodi është kompetente, për shkaqe të rëndësishme ose për arsye të efikasitetit, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të vendos veçimin e procedurave të zbatuara për disa vepra penale ose kundër disa të pandehurve dhe **procedon ndaras ose çështjet** e ndara ia dërgon një gjykate tjetër kompetente.

Paragrafi 2. Aktvendimin për veçimin e procedurës e merr gjykata kompetente pas dëgjimit të plëve dhe mbrojtësit.

c) Nxjerrja e përfundimeve gjyqësore se për dy veprat penale të grabitjes a plotësohen kushtet ligjore që të trajtohen si vepër penale e grabitjes së vazhduar

Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se veprat penale e grabitjes në dispozitivin I. dhe II të aktit akuzues trajtohen si një **vepër penale e grabitjes në vazhdim** për arsyet me sa vijon:

-sipas nenit 77 paragrafi 1. nënparagrafi 1.5 të KPRK-s nga provat personale dhe materiale në shkresa të lëndës edhe pse të paadministruara më datën 11 dhe 12 tetor të vitit 2022 tek i akuzuari L. ka ekzistuar **dashja e njëjtë si formë e fajit**, edhe atë që tek dy subjektet e lartcekura të realizoj **dobi pasurore monetare në mënyrë të kundërligjshme për vete**,

-sipas paragrafit 1 nënparagrafi 1.2 të të njëjtit nen nga provat në shkresa të lëndës edhe pse të paadministruara **dobia pasurore e fituar në mënyrë të kundërligjshme përmes grabitjes është e natyrës së njëjtë**, përkatësisht kjo **dobi është e karakterit monetar** edhe atë në shumat prej **490 Euro** përkatësisht **530 Euro**. Pra, kemi të bëjmë **me objekt të natyrës së njëjtë**.

-i pandehuri me **plan paraprak** ka ndërmarr veprimin inkriminues ndaj subjekteve të dëmtuara të cilat që të dyja e kanë selinë në Gjilan dhe gjenden në afërsi relative por të shënjestruara paraprakisht nga i akuzuari L. për të grabitur tek të njëjtat. Në këtë rast në një pikëpamje është plotësuar edhe kushti ligjor nga neni 77 paragrafi 1. nënparagrafi 1.4 të KPRK-s,

-i pandehuri ka planifikuar më parë që me **armën me gaz** e cila aspak nga qytetari i rëndomtë nuk mund të dallohet nga arma – revolva e vërtetë e zjarrtë **të kryej grabitje të parave** tek subjektet e lartëcera të shënjestruara paraprakisht, edhe tek njëri subjekt më datën **11 tetor** kurse tek subjekti tjetër më **12 tetor të të njëjtit vit**.

Meqë sipas nenit 77 paragrafi 1. të KPRK-s shprehimisht parashihet se **vepra penale në vazhdim** përbëhet nga disa vepra të natyrës së njëjtë ose të ngjashme si në rastin konkret lidhur me **dy ngjarjet inkriminuese** me të cilat konsumohet **vepra penale e grabitjes** nga neni 317 paragrafi 1. të KPRK-s mirëpo meqë në të dy ngjarjet inkriminuese i akuzuari ka përdorë armën, vepra është kualifikuar në aspektin juridik nga paragrafi 3 të nenit 317 të KPRK-s. Këto dy vepra penale sipas nenit 77 paragrafi 1. të KPRK-s janë kryer në lidhmëri kohore duke u

planifikuar paraprakisht edhe atë më datën 11 dhe 12 tetor 2021 duke u shënjestruar paraprakisht dy subjektet ekonomike të lartcekura me seli në Gjilan në një afërsi relative njëra me tjetrën, e të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy kushteve ligjore nga n[paragrafi 1.5, 1.4, 1.3 dhe 1.2 të të njëjtit nen, të cilat janë arsyetuar më gjerë më lartë në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vlen të theksohet se shprehimisht është paraparë me paragrafin 2. të nenit 77 të KPRK-s se veprat penale të kryera kundër personit (p.sh. Vrasje në tentativë, lëndim i rëndë trupor, lëndim i lehtë trupor dhe veprimet tjera të cilat janë të lidhura me integritetin trupor dhe jetën e viktimës e jo vetëm në këto raste) mund të konsiderohen **si vepër penale në vazhdim** vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person, mirëpo sipas paragrafit 3 të të njëjtit nen shprehimisht parashihet **se veprat penale në vazhdim** të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk mund të bashkohen në një vepër, nuk konsiderohen vepra penale në vazhdim.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ngjarje penale të natyrave nga paragrafi 2 dhe 3 të nenit 77 të KPRK-s, pasi që të njëjtat janë të drejtuara ndaj dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme dhe se qëllimi i të akuzuarit L. në të dy situatat injriminuese të lartcekurta pikërisht edhe në atë drejtim është planifikuar nga i njëjti, duke u shënjestruar paraprakisht dy subjektet e dëmtuara në fjalë.

Mbi këtë bazë edhe trupi gjakues është përcaktuar që dy ngjarjet penale si dy akuza në aktakuzën lëndore për të cilat i akuzuari ka pranuar fajësinë, t'i komponoj në një përskrim faktik, duke i kualifikuar dy veprat penale të grabitjes si një vepër penale të grabitjes në vazhdim nga neni 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 77 të KPRK-s, për të cilën edhe të akuzuarin L. e ka shpallur fajtor duke i caktuar dënimet kumulative si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Po ashtu të akuzuarin L. e ka shpall fajtor edhe për veprën penale të **mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1.** të KPRK-s, meqë i njëjti ka pranuar fajësinë dhe gjykata sipas nenit 326 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1. të KPP-s me aktvendim e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit.

Vlen të theksohet se sipas nenit 113 paragrafi 1 nënparagrafi 40 të KPRK-s aemë konsiderohet çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, ... gazrave nën presion, ... që hedhë predha në formë të një plumbi të vetëm, ... gazi, ... që krijohet dhe **përdoret për të shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik...** Bile sipas pikës 40.3 të nënparagrafit 40 të të njëjtit nen armë konsiderohen edhe armët pneumatike (ajrore). Në rastin konkret i akuzuari L. dy ditët kritike me rastin e kryerjes së grabitjeve, me rastin e kryerjes së dy grabitjeve të parave nga kasieret e dy subjekteve ekonomike ka përdorur armën me gaz Recs me gaz mod.PP, të kalibrit 9mm, me numër serik M157471, made in Germany, të cilën e mbante në posedim dhe kontroll pa leje nga organi kompetent administrativ. Mbi këtë bazë edhe vetëm posedimi i paautorizuar dhe mbajtja nën kontroll e armës lëndore ka konsumuar tek i akuzuari L. tuiparet e veprës penale nga neni 366 paragrafi 1. të KPRK-s, për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar si në dispozitiv i akuzuari në fjalë.

ç) Rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe përcaktimi i gjykatës për llojin dhe lartësinë e dënimeve kumulative unike

Gjykata me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese në kuptim të nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-s edhe atë si në vijim : pranimin e fajësisë, pendimin e sinqert për veprimin e pamatur të tij, premtimin se nël të ardhmen do të

përmbahet nga veprimet e tij që bien ndesh me ligjin, gjendjen e tij shëndetësore me theks të veçantë aftësinë e zvogëluar mendore të tij për shkak të çrregullimit mendor të quajtur “ çrregullim organik i personalitetit të akuzuarit të koduar me shifrën F 07.8 sipas ICD 10 Epi secondaria “ të përcjellur me çrregullime të sjelljes, mosrespektimit të normave shoqërore, abuzimit me substanca psikoaktive por edhe me ataqe epileptike si pasojë e sëmundjes bazë të njëjtë i cili konsiston në mënjanimin e tumorit në kokë (të ekstirpuar), gjendjes së varfër ekonomike, moshën relativisht të re të tij por edhe nivelin e ultë të arsimimit të tij pmeqë i njëjti ka të kryer vetëm shkollën fillore tetëvjeçare përfshirë edhe rrethanat nën të cilat jeton i njëjti në pjesën rurale larg qendrës urbane, rrethana këto të cilat në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të KPRK-s ashtu të sublimuara paraqesin rrethana veçanërisht lehtëuese. Duke i pasur parasysh rrethanat e tilla lehtësuese edhe pse në rastin konkret i akuzuari ka të kaluar kriminale lidhur me abuzimin me substanca psikoaktive – përkundër asaj që organi i ndjekjes penale nuk i ka sjell gjykatës kurrëfatë aktgjykimi të plotëfuqishëm mirëpo këtë e ka pranuar vet ky i pandehur sipas data bazës policore, gjykata konsideron se i akuzuari L. ligjërisht nuk mund të konsiderohet si recidivist edhe pse në rastin konkret akuzohet për tri vepra penale, e dy të paraqet janë kualifikuar si grabitje në vazhdim, mirëpo këtë sjellje kriminale të akuzuarit trupi gjykues do ta ketë parasysh me rastin e përcaktimit për lartësinë e dënimeve kumulative.

Trupi gjykues në kuptim të nenit 76 paragrafi 1. të KPRK-s fillimisht për veprën penale grabitja në vazhdim në kuptim të nenit 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 dhe nenin 77 të KPRK-s ka caktuar dënim kumulativ edhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) viteve e gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind (900) Euro kurse për veprën penale nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-s i ka caktuar dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) Euro, e në zbatim të nenit 76 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.5 të KPRK-s duke i pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cilat ashtu të sublimuara paraqesin rrethana veçanërisht lehtësuese, ka ardhur në përfundim se me dënimet kumulative edhe atë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tri vite e gjashtë muaj dhe dënimin unik me gjobë në shumën prej 1,200 Euro, në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 në zbatim të nënparagrafit 1.2 të njëjtë nën si dispozitë më e favorshme për të akuzuarin, do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në bazë të nenit 38 të KPRK-s, duke e parandaluar të akuzuarin L. që në të ardhmen mos të kryej vepra penale, me bindje se edhe me këto dënime i njëjti do të rehabilitohet duke u bërë i dobishëm për shoqërinë, familjen, rrethinë në të cilin jeton por edhe për vetveten, kurse në anën tjetër qytetarët potencial do të disiplinohen që mos të bien ndesh me ligjin nën kërcënim të pasojave evidente që i ka pësuar i akuzuarin me dënimet lëndore.

Trupi gjykues konsideron se me dënimet kumulative unike gjykata ka shpreh gjykimin shoqëror për shkak të sjelljes inkriminuese të këtij të akuzuari, me të cilat janë konsumuar elementet e figurave të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor, me synim që tek i akuzuari në fjalë dhe qytetarët potencial të ngrit moralin dhe forcoj detyrimin për respektimin e të mirave juridike si vlera relevante të mbrojtura me të drejtën pozitive penale, duke i disiplinuar të njëjtë që të jetojnë dhe veprojnë në pajtim me ligjin, me djersën e tyre e jo duke grabitur të mirat monetare nga të tjerët për të realizuar dobi materiale në mënyrë të kundërligjshme.

Me rastin e shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPRK-s, kryetari i trupit gjykues ka dhënë arsyetim të shkurtër edhe pse përmbajtësor duke i udhëzuar palët për të drejtën në ankesë, kurse të akuzuarin për dënimet e shqiptuara ashtu siç edhe janë shpallur, me një sqarim se dënimi me burgim mund të ekzekutohet edhe në mënyrë të dhunshme nëse i akuzuari nuk paraqitet në gjykatë për t’u udhëzuar për mbajtje të dënimit por vetëm pas plotëfuqishmërië së

këtij aktgjykimi të pranuar nga i akuzuari. Ndërsa poqese eventualisht i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s do të ekekutohet dënimi i zëvendësuar me burgim.

Po ashtu vlen që të theksohet se trupi gjykues me rastin e vendosjes **nuk i ka marrë parasysh rrethanat rënduese ashtu siç i ka formuluar dhe propozuar përfaqësuesi i aktakuzës** : **“shkallën e lartë të rrezikshmërisë shoqërore , shkallën e lartë të elementit të dashjes për të kryer veprën penale, se vepra penale është kryer nën kërcënim të armës, se në rastin konkret kemi tri viktima ose thjeshtë tre të dëmtuar dhe mënyrën e kryerjes së veprave penale “** me arsyetim si në vijim : sa i përket rrethanës rënduese “ shkalla e lartë e rrezikshmërisë shoqërore “ e njëjta është e inkorporuar në vet dispozicionin dhe sanksionin e paraparë të veprave penale lëndore si vepra të posaçme, lidhur me rrethanën rënduese “ shkalla e lartë e dashjes së të akuzuarit “ vërtetë kjo rrethanë është paraparë shprehimisht në nenin 70 paragrafi 2 nënparagrafi 2 të KPRK-s, mirëpo përgjegjësia penale si element subjektiv i veprës penale përbëhet prej dy elementeve : përgjegjshmërisë penale dhe fajësisë, kurse fajësia në kuptim të nenit 21 përbëhet prej dashjes e cila mund të jetë direkte dhe eventuale, e që në rastin konkret kemi të bëjmë me dashje direkte, pasi që i akuzuari L. dy ditët kritike ka vepruar me dashje direkte, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe shkaktimin e pasojës e ka dëshiruar në kuptim të paragrafit 2 të nenit 21 të KPRK-s. Sa i përket rrethanës rënduese “ **se vepra është kryer nën kërcënim të armës** “ kjo rrethanë është konsumuar me veprën e posaçme të grabitjes në vazhdim nga neni 317 paragrafi 3 të KPRK-s sepse njëkohsisht nuk mund të shfrytëzohet e njëjta rrethanë edhe për ta bërë veprën penale të kualifikuar si në rastin konkret edhe si rrethanë rënduese.

Sa i përket rrethanës rënduese të cekur nga përfaqësuesi i aktakuzës “ **se në rastin konkret kemi tri viktima ose thjeshtë tre të dëmtuar** “ i njëjti nuk ka dhënë sqarime konkrete, mirëpo në rastin konkret kemi të bëjmë me dëmtim monetar të dy subjekteve ekonomike të theksuara më lart, por edhe dy të dëmtuara si persona fizik, të cekur më lart. Mirëpo në rastin konkret, përfaqësuesi i aktakuzës për kanosje, sulm ose lëndim të lehtë trupor përkitazi me këto dy të dëmtuara si persona fizik me aktakuzën lëndore nuk ka akuzuar të akuzuarin L. Z. edhe pse i njëjti paraprakisht ndaj këtyre të dëmtuarave si kasiera ka përdorur **dhunën fizike por edhe kanosjen me armë**, mirëpo shkaktimi i lëndimeve të lehta trupore të njëjtave sipas dispozitës ligjore nga neni 317 të KPRK-s nuk parashihet si element objektiv kualifikues, krahas rrethanave tjera siç janë : tejkalimi i vjerës prej 5,000 Euro, kur kryesi i veprës penale vepron si anëtarë i grupit, ose vepra rezulton me lëndim të rëndë trupor të viktimës ose me vdekjen e saj. PO ashtu duhet theksuar se vërtetë sipas nenit 70 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 të KPRK-s shprehimisht si rrethanë rënduese parashihet edhe rrethana “ nëse vepra penale përfshinë disa viktima “ mirëpo me vet faktin që ndaj dy të dëmtuarave si persona fizik – të cilat kanë punuar si kasiera tek subjektet ekonomike të cekura më lartë, është përdorë **dhuna përkatësisht kanosja serioze** nga ana e të akuzuarit L. dy ditëve kritike, këto rrethana janë elemente përbërëse të dispozicionit të nenit 317 të KPRK-s si vepër penale bazë – themelore, andaj edhe në të njëjtën kohë nuk mund të merren si rrethana rënduese në të njëjtën kohë me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit. Dobia pasurore monetare nga ana e të akuzuarit L. është rrealizuar nga dy subjektet ekonomike përkatësisht financiare, mirëpo derisa si kasiera kanë qenë duke punuar të dëmtuarat tek këto subjekte, ndaj të njëjtave i akuzuari ka përdor dhunën fizike por edhe kanosjen me armë ndaj tyre. Sa i përket rrethanës tjetër rënduese të paraqitur nga përfaqësuesi i aktakuzës “ **mënyra e kryerjes së veprave penale** “, gjykata konsideron se edhe ky element objektiv është konsumuar tek vepra penale e grabitjes në vazhdim si vepër penale e posaçme edhe pse e sublimuar nën kushtet ligjore nga neni 77 të KPRK-s.

d) Konfiskimi i armës, parave dhe i sendeve tjera dhe llogaritja e paraburgimit në dënimin me burgim

Në kuptim të nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-s është bërë konfiskimi i armës lëndore me gaz, kurse në kuptim të nenit 284 të KPP-s i shumës së sekuestruar të parave dhe sendeve tjera si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 79 të KPRK-s të akuzuarit koha e kaluar në paraburgim i është llogaritur në dënimin me burgim.

dh) Shpenzimet e procedurës penale, paushalli gjyqësor dhe kompensimi i viktimave të krimit

Në kuptim të nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.1 të KPP-s lidhur me nenin 453 është vendosur për shpenzimet e procedurës penale lidhur me ekspertizën e ekspertëve psikiatër, ndërsa duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë dhe kohëzgjatjen e procedurës penale sipas kësaj lënde penale në kuptim të nenit 450 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 të KPP-s është vendosur për paushallin gjyqësor.

Për detyrimin e të akuzuarit për pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit ka vendosur në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

e) Kërkesa pasurore juridike e subjekteve ekonomike dhe e të dëmtuarave

Trupi gjykues duke pasur parasysh faktin se i akuzuari L. Z. ka pranuar fajësinë për dy vepra penale të grabitjes, të cilat në kuptim të nenit 77 të KPRK-s janë trajtuar si vepër penale e grabitjes në vazhdim në kuptim të nenit 317 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 77 të KPRK-s, në përshkrimin faktik të të cilës vepër penale decidivisht është theksuar se më datën 11 tetor 2021 ky i akuzuar nga kasa nën kërcënimin me armë ka grabitur shumën prej **490 Euro**, ku si palë e dëmtuar është subjekti financiar “ **Ria Vilesa Transfer** “ me seli në Gjilan, shumë kjo e cila mbulohet me listën zyrtare me rastin e pranim-dorëzimit të detyrës mes kasierës **D. D.** dhe kasierës tjetër të datës 11.10 2021 kurse nga kasa nën kërcënim me armë ka grabitur shumën prej **530 Euro**, ku si palë e dëmtuar është subjekti ekonomik **BUM 3 Market** me seli në Gjilan. Shumë pko e cila mbulohet me listën zyrtare me rastin e pranim-dorëzimit të dretyrës mes kasierës **Sh. Rr.** nga Gjilani dhe kasierës tjetër të datës 12 tetor 2021.

Mbi këtë bazë edhe gjykata ka vendosur që këto shuma detyrohet që i akuzuari L. t’ua paguaj subjekteve në fjalë, edhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm të aktgjykimit të plotfuqishëm.

Pasiqë të dëmtuarat D. D. dhe Sh. Rr. nuk i kanë ofruar prova për mbështetjen e kërkesave pasurore juridike, duke mos mbuluar dhe caktuar as lartësinë e kërkesave të tilla pasurore

juridike, e në anën tjetër për këto kërkesa vlen parimi i disponibilitetit të palëve e jo normat imperative – kogente për të vendosur detyrimisht gjykata sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 463 paragrafi 2 lidhur me nenin 460 të KPP-s të dëmtuarat në fjalë lidhur me kompenzimin e kërkesave të tyre paurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Vlen të theksohet se decidivisght sipas nenit 460 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPP-s parashihet : personi i autorizuar për paraqitjen e propozimit për realizimin e kërkesës pasurore në procedurë penale detyrohet ta parashtrij kërkesën e vet në mënyrë të qartë dhe të paraqes prova për mbështetjen e kërkesës së tillë.

Për arsyet e lartcekura u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 183/2021, më datën 12 prill të vitit 2022**

Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi

Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri, d.v.

Udhëzim për mjetin juridik : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet **ankesë** në **Gjykatën e Apelit – Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda**, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit ekzemplarit të vërtetuar të të njëjtit. Ankesa i dorëzohet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatë dhe palën kundërshtare.

(**Vërejtje** : në kuptim të nenit 369 paragrafi 4 të KPP-s kopja e vërtetuar e këtij aktgjykimi së bashku me udhëzimin për të drejtën në ankesë i dërgohet palëve – të dëmtuarit-ve si subjekte financiare përkatësisht ekonomike si dhe të dëmtuarave në fjalë si persona fizik në adresat si në shkresa të kësaj lënde penale).